


SHMANGIA E REVISTAVE TË DYSHIMTA DHE  
E KONFERENCAVE TË DISKUTUESHME

# UDHËZUES RRETH MUNDËSIVE







SHMANGIA E REVISTAVE  
TË DYSHIMTA DHE E  
KONFERENCAVE TË  
DISKUTUESHME

**UDHËZUES  
RRETH  
MUNDËSIVE**



**Shënim:** Ky artikull është përkthyer me leje të autores. Për çfarëdo paqartësie që mund t'ju shfaqet, ju sugjerojmë t'i referoheni artikullit original në gjuhën angleze.

Design: *envinion*

# Abstrakt

**Qëllimi:** Synimi i këtij udhëzuesi është të sigurojë një përmbledhje të qartë rreth temës së revistave të dyshimta dhe të konferencave të diskutueshme, me këshilla se si t'u shmangeni atyre. Ky udhëzues qëllimisht përvetëson një qasje me gjuhë të thjeshtë për të qenë sa më i kuptueshëm për lexuesit me nivele të ndryshme të zotërimit të gjuhës angleze.

**Metodat:** Kërkimet elektronike janë kryer dorazi, duke përdorur Google dhe Google Scholar, krahas me kërkimin e databazave të hulumtimit të bibliotekave në Universitetin e Calgary-t. Termat e kërkimit përfshinin: *revistat e dyshimta, botues i dyshimtë, konferencë e dyshimtë, konferencë e diskutueshme dhe konferencë vanitoze*. Tri lloje kryesore të burimeve e begatuan këtë raport: (1) publikime studiuesish të shqyrtuara nga kolegët; (2) media popullore me nam siç janë gazetatat e mirënjohura; dhe (3) literatura e hirtë siç janë blogjet e shkruara nga ekspertë dhe studiues.

**Gjetjet:** Jepen vështrime me gjuhë të thjeshtë të botimeve të dyshimta dhe të konferencave të diskutueshme për t'i ndihmuar studiuesit të kuptojnë çka janë ato dhe si të shmangen. Përfshihet një diskutim se si të kuptojë ku duhet të botojë punimin e vet një autor aspirues, si dhe një listë kontrolli për të përcaktuar nëse një konferencë ia vlen kohën dhe mundin e prezantuesit potencial.

**Implikimet:** Ka implikime për mentorët e studentëve pasdiplomikë dhe akademikët në fillimet e karrierës, si dhe për institucionet në tërësi. Çështja e konferencave dhe e botimeve të diskutueshme është aq komplekse, sa akademikët në fazat e hershme kërkojnë mbështetje dhe mentorim për të krijuar një mirëkuptim më të thellë se si ta ndajnë punën e vet me komunitetin në mënyrë të besueshme.

**Materialet shtesë:** Përmban 66 referenca dhe 2 tabela.

**Fjalët kyçe:** revista, konferenca, botime, të dyshimta, hulumtime



# Përmbajtja

<b>HYRJE</b> .....	<b>8</b>
<b>AUDIENCA E SYNUAR</b> .....	<b>9</b>
<b>METODA</b> .....	<b>11</b>
Kriteret e përzgjedhjes.....	12
Procedura e kërkimit.....	12
Procedura e analizës dhe sintezës.....	12
<b>NGRITJA E GRABITQARIT NË KËRKIM TË PËRFITIMEVE</b> .....	<b>13</b>
Të motivuar nga paratë.....	13
Marketingu i paskrupullt.....	13
Mungesa e besueshmërisë dhe cilësia e ulët.....	14
Tiparet e kontribuesve.....	14
<b>TË KUPTUARIT E QASJES SË HAPUR DHE TË TPA-VE</b> .....	<b>17</b>
<b>REVISTA TË DYSHIMTA</b> .....	<b>18</b>
Tiparet e revistës së dyshimtë.....	18
Si ta kuptoni ku ta publikoni punimin tuaj.....	19
<b>KONFERENCAT E DISKUTUESHME</b> .....	<b>21</b>
Tiparet e konferencës vanitoze ose të dyshimtë.....	21
Si ta përcaktoni nëse konferenca është e diskutueshme.....	24
<b>IMPLIKIMET</b> .....	<b>26</b>
Pasojat për kontribuesit.....	26
Implikimet për mentorët.....	26
Implikimet për akademinë .....	27
<b>PËRMBYLLJE</b> .....	<b>28</b>
<b>REFERENCAT</b> .....	<b>29</b>
<b>RRETH AUTORES</b> .....	<b>35</b>

# Hyrje

Para pak kohësh, një student pasdiplomik ishte joshur nga një konferencë pikërisht nga fusha e tij të studimit dhe po më njoftonte me shkrim se e kishin pranuar. Nuk kisha dëgjuar kurrë për atë konferencë. Asnjëherë nuk ia kisha hasur emrin as shkarazi. Punoj në arsimin e lartë prej gati një çerek shekulli dhe kam dëgjuar për shumë konferenca legjitime e të besueshme në fushën time, prandaj u bëra skeptike.

Pyeta shumë kolegë, si dhe bibliotekarin tonë rezident. Askush tjetër nuk kishte dëgjuar për konferencën. Bibliotekari ynë i arsimit në Universitetin në Calgary, Dr. Bart Lenart, meriton falënderime, meqë u fut në telashe të mëdha për të përcaktuar nëse konferenca ishte e ligjshme. Në fund, vendosëm se ajo nuk ishte shpenzim i mençur as i parave as i kohës së studentit.

Si rezultat i asaj përvoje, fillova ta hetoja temën e konferencave dhe revistave të dyshimta në thellësi. E fillova këtë udhëzues duke menduar për studentët e tjerë pasdiplomikë dhe akademikët e rinj, që rrezikojnë të joshen për të shpenzuar mjete të vlefshme për pjesëmarrje, duke mos bërë asgjë për ta përparuar nxënien, zhvillimin profesional, përvojën studimore a reputacionin. Pritshmëritë janë të larta për akademikët dhe trysnia për të dhënë rezultate ndonjëherë mund të jetë tepër e madhe. Ky udhëzues synon t'i ndihmojë studiuesit që të marrin vendime të mençura se si ta shpenzojnë kohën, paratë dhe mjetet, duke e mbrojtur dhe ruajtur njëkohësisht reputacionin profesional.

Këtu nuk do të ofroj ndonjë listë revistash ose konferencash që, për mendimin tim, janë të dyshimta. Beall (n.d.) ka bërë tashmë një punë të shkëlqyeshme lidhur me këtë. Ai madje edhe vuajti për shkak të mundit të vet (Basken, 2017). Të tjerëve u është dashur të bëjnë korigjime në botimet e veta, pasi kanë lënë të nënkuptohet se disa ngjarje mund të jenë të dyshimta (McCrostie, 2016). Kam mësuar përmes hulumtimit tim se përmendja e emrave mund të sjellë më shumë telashe sesa ia vlen, prandaj nuk do ta bëj këtë. Në vend të kësaj, do t'ju ofroj një përmbledhje të asaj që një revistë a një konferencë e bën të diskutueshme dhe do t'ju mësoj disa metoda, që të mund të merrni vendim të informuar për vetveten.

Grove (2017b) pohonte se numri i konferencave të dyshimta tashmë i tejkalon ngjarjet zyrtare. Me “ngjarje zyrtare”, ai nënkupton konferencat e organizuara nga shoqatat dhe asociacionet e ligjshme studiuese (Grove, 2017b). Ndonëse problemi duket më i keq në shkencat fizike, as disiplinat e tjera nuk janë imune (Nicoll & Chinn, 2015). Numri i lartë i konferencave dhe i revistave të dyshimta do të thotë se akademikët aspirues dhe të rinj duhet të jenë më të vëmendshëm se kurrë më parë për mbrojtjen e reputacionit të tyre. Në akademi, reputacioni është gjithçka. Nuk ia vlen të joshesh nga premtimi për pranim të lehtë në një konferencë apo të një botimi.



# Audienca e synuar



FOTOGRAFIA NGA: COLOURBOX.COM

Këtë udhëzues e shkrova për studentët pasdiplomikë, studiuesit dhe këdo që është i interesuar të mësojë më shumë rreth konferencave të diskutueshme ose revistave të dyshimta. Presion i madh vihet mbi akademikët aspirues dhe ata në fillimet e karrierës për të demonstruar aftësinë e tyre për të prodhuar. Ky presion nënkupton nxjerrjen e prezantimeve për konferencë, si dhe të botimeve, për të dëshmuar se janë të denjë për karrierë akademike, ose promovim nëse tashmë e mbajnë një pozitë të tillë.

Ky udhëzues mund të jetë i dobishëm edhe për ata që ndodhen në fazë më të avancuar në karrierë. Para disa kohësh, një koleg më erdhi në zyrë për të më kërkuar këshillë. Po shqyrtonte një kërkesë kontrate të pacaktuar për një profesor të ri, dhe ishte i shqetësuar. “A po boton ky person në revista të dyshimta?”, më pyeti. Nuk e pyeta kush ishte profesori i ri. Pyeta cilët ishin titujt e revistave. U ulëm bashkë në zyrën time dhe bëmë disa hetime. Në fund, përcaktuam se akademiku i ri po botonte në revista legjitime dhe të besueshme. Shqyrtuesi thjesht nuk i njihnte revistat në fjalë, sepse nuk ishin nga fusha e ekspertizës së tij. Mësohemi me revistat dhe konferencat në fushën tonë të veçantë, por t’ia vlerësosh kredibilitetin dikujt jashtë fushës tënde mund të jetë gjë e ndërlikuar.

Aq shumë revista dhe konferenca të reja dalin, sa mund të jetë e vështirë, edhe për akademikun me përvojë, që ta dijë dallimin (Eriksson & Helgesson, 2017). E rëndësishmja këtu është se reputacioni i akademikut të ri - dhe e ardhmja e tij në karrierë - ishin në shqyrtim. Kur akademikë të vjetër që shqyrtojnë aplikimin tuaj për vazhdim kontrate hetojnë nëse po botoni në revista të dyshimta, kjo tregon se sa seriozisht e marrin çështjen.

Është thelbësore për të gjithë ata që punojnë, ose synojnë të bëjnë punë akademike, që të dinë të identifikojnë konferenca dhe publikime me reputacion - dhe t'i shmangin të tjerat.



## Metoda

Qëllimi im me këtë udhëzues është të ofroj një përmbledhje të përgjithshme, por gjithëpërfshirëse, me gjuhë të thjeshtë të temave kryesore rreth (1) revistave të dyshimta dhe botimeve dhe (2) konferencave të diskutueshme, të dyshimta ose vanitoze. Trajtimi për secilën temë ofron analizë dhe sintezë të gjetjeve të mia, me sugjerime praktike për akademikët. Ka arsye të fortë pse përvetësohet qasja e gjuhës së thjeshtë në shkrimin akademik (Alford, 2017; Szala-Meneok, 2007).

Doja të shkruaja një udhëzues që të ishte i arritshëm për akademikët me nivele të ndryshme të zotërimit të anglishtes, prandaj zgjodha një qasje me gjuhë të thjeshtë për shkrimin. Do të shtoj se megjithëse termi 'i dyshimtë' është i diskutueshëm (Christopher & Young, 2015), e kam përdorur në këtë udhëzues sepse zakonisht përdoret dhe kuptohet midis akademikëve.

## KRITERET E PËRZGJEDHJES

Ky udhëzues nuk ka për qëllim të japë përmbledhje të plotë të literaturës për të gjitha burimet e mundshme, megjithëse kam konsultuar një gamë thelbësore dhe gjithëpërfshirëse burimesh për ta bërë këtë punë. Kriteret e mia të përzgjedhjes përfshijnë:

- 1 Artikuj dhe editoriale të revistave të botuara nëpër revista të besueshme shkencore dhe kërkimore.
- 2 Artikuj të mediave popullore të botuara në gazeta dhe portale interneti shumë të respektuara, si p.sh. *Times Higher Education*.
- 3 “Literaturë të hirtë”, si postime blogjesh të shkruara nga udhëheqës të mendimit dhe ekspertë me interesim të thellë për këto çështje (p.sh. blogu i Beall-it').
- 4 Burime të publikuara për audiencë ndërkombëtare, shkencore ose akademike ndërkombëtare.

## PROCEDURA E KËRKIMIT

Bëra një kërkim në internet gjatë një periudhe tetëjavore që përfshinte termat e kërkimit: *revista të dyshimta*, *botues i dyshimtë*, *konferencë e dyshimtë*, *konferencë e diskutueshme* dhe *konferencë vanitoze*. Strategjitë e kërkimit i përqendrova në burimet elektronike nga:

- 1 Kërkimet manuale duke përdorur Google dhe Google Scholar.
- 2 Bazat e të dhënave të bibliotekës së Universitetit në Calgary.
- 3 Kërkimin referues, duke përdorur informacion bibliografik të burimeve të zgjedhura.

## PROCEDURA E ANALIZËS DHE SINTEZËS

Mblodha burime dhe krijova një listë referimi të burimeve përkatëse dhe strategjike duke përdorur Endnote. Shqyrtova secilin burim në detaje, duke marrë shënime mbi temat e përsëritura ose të zakonshme, si karakteristikat e konferencave të diskutueshme. Duke përdorur këto shënime, i sintetizova gjetjet me gjuhë të thjeshtë, duke u referuar në burime ndërsa po shkruaja.

---

1 Shih: <https://beallist.weebly.com/>

# Ngritja e grabitqarit në kërkim të përfitimeve

Ky udhëzues shqyrton si botimet e dyshimta ashtu edhe konferencat e tilla. Ekzistojnë disa ndryshime të dallueshme midis tyre, por ka edhe të përbashkëta që ia vlen të hulumtohen.

## TË MOTIVUAR NGA PARATË

Dallimi mes një reviste ose konference legjitime dhe të diskutueshmes mund të lidhet drejtpërdrejt me motivin e saj për ekzistencë. Nëse misioni kryesor i një reviste ose konference është avancimi i njohurive dhe shkëmbimi i gjetjeve të reja shkencore e kërkimore, pas një procesi të përcaktuar dhe rigoroz të recensimit, atëherë sipas gjasave është e besueshme. Nga ana tjetër, nëse qëllimi kryesor i revistës ose i konferencës është të fitojë para duke pasur pak kujdes për përhapjen e punës cilësore, ajo sipas gjasave është e dyshimtë, ose të paktën, e diskutueshme.

## MARKETINGU I PASKRUPULLT

Përgjegjës për botime ose ngjarje të dyshimta përfshihen në promovim të paskrupullt. E-maillet spam për kontribuesit potencialë janë të zakonshme. Mesazhet e tyre spam shpesh dallohen nga:

- 1 gramatika e dobët
- 2 drejtshkrimi i dobët
- 3 gjuha hiperbolike që mburret sa prestigjioze është konferenca
- 4 lajkat për kontribuesin potencial, për t'i bërë thirrje egos së tij ose papërvojës
- 5 mungesa e butonit për t'u "çregjistruar" ose për të mos marrë më mesazhe
- 6 logot që duken të ngjashme me ato të botuesve të besueshëm

## MUNGESA E BESUESHMËRISË DHE CILËSIA E ULËT

Përfundimisht, botimet dhe konferencat e dyshimta nuk bëjnë asgjë për t'i përparuar njohuritë shkencore dhe as nuk e ngrejne reputacionin e atyre që në to kontribuojnë. Fjalë të tilla si “hile”, “rreng”, “i korruptuar”, “mashtues” dhe “false” janë përdorur për të përshkruar këto revista ose ngjarje (Abbott, 2017; Beall, 2012; Eriksson & Helgesson, 2017; Jalalian, & Mahboobi, 2013; Pai & Franco, 2016;).

Ata që fshihen pas këtyre mashtrimeve kanë pak “shqetësim të mirëfilltë për përmbajtjen” (Eriksson & Helgesson, 2017, f. 163). Pajsa e një produkti përfundimtar që jep kontribut intelektual në kërkim dhe studime është pa rëndësi për botuesin e revistës ose organizatorin e konferencës së dyshimtë.

## TIPARET E KONTRIBUESVE

Këto revista ose konferenca quhen “grabitqare” në anglisht sepse ato tekstualisht gjuetojnë për akademikë të etur për të fituar përvojë prezantimi dhe botimi të studimeve. Kjo nënkupton se këto botime ose ngjarje qëllimisht shënjestrojnë lloje të caktuara individësh, bash sikur të gjuanin për pre, por kjo nuk i përshkruan me saktësi shumë prej këtyre organizatave, që në vend të kësaj i ngarkojnë me spam kontribuesit e mundshëm pa dallim dhe egërsisht. Beall (2016) përdor si term përshkruar edhe cilësimin “parazitare” (f. 1511), që është sidomos i dobishëm kur i shqyrtojmë llojet e individëve që në to kontribuojnë, pasi që disa duket se përfitojnë në mënyrë simbiotike nga marrëdhënia, kurse të tjerët ndjehen të dobësuar profesionalisht nga përvoja e tyre me to.

Pas ekzaminimit të literaturës (Beall nd. 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 a, b, c; Grove, 2017a; McCrostie 2016, 2017; Nicholl & Chinn, 2015; Nolfi, Lockhart & Redgate, 2015; Vinny, Vishnu & Lal, 2016; Xia, Harmon, Connolly, Donnelly, Anderson, & Howard, 2015; Ruben, 2016), ata që kontribuojnë në botime ose ngjarje të dyshimta ose parazitare, duket se ndahen në tri kategori kryesore: (a) ata që janë tepër naivë për të kuptuar; (b) ata që janë në dijeni, por nuk e kanë problem; dhe (c) ata pseudoshkencëtarë që hiqen si studiues ose hulumtues të ligjshëm, por në thelb janë vetë mashtues ose sharlatanë.

***Kontribuesi naiv*** në fund e kupton se kontributi i vet nuk do t'i sjellë shumë përfitime dhe se reputacioni madje mund t'i dëmtohet.



**Kontribuesi në dijëni** ka një marrëdhënie më simbiotike me publikimin ose konferencën parazitare sepse parasheh njëfarë përfitimi për avancimin e vet.

Ashtu si kontribuesi në dijëni, **edhe pseudoshkencëtari** merr (ose së paku parasheh) përfitime, sepse konferencat ose botimet e dyshimta i japin një vend për ta shpallur ekspertizën, rezultatet e paprovuara ose teoritë absurde.

Tabela në faqen tjetër ofron një përmbledhje të këtyre llojeve të ndryshme. Është e rëndësishme të kuptohet se këto përshkrime nuk janë fikse ose të përhershme. Dikush mund të jetë kontribues naiv vetëm një herë dhe pastaj të bëhet më i kujdesshëm se ku vendos t'i publikojë punimet e veta në të ardhmen.

**Tabela 1: Tiparet e kontribuesve në revista ose konferenca të dyshimta**

Lloji	Tiparet
<b>Naivët</b>	Akademikët në këtë kategori janë të papërvojë, të përkorë ose naivë. U mungon vetëdijesimi se po shënjestrohen nga një publikim ose konferencë e dyshimtë. Këto kontribute kanë një tipar rastësor, sepse kontribuesit besojnë që puna e tyre është përzgjedhur për shkak të meritave të veta dhe është shqyrtuar ligjërisht nga kolegë. Sidomos akademikët pa përvojë mund të joshen për t'i paraqitur punimet në revista të diskutueshme, nëse puna u është refuzuar nga revista të kalibrit shumë të lartë (Nicoll & Chinn, 2015). Kur kontribuesit zbulojnë se janë përfshirë në një revistë a konferencë të diskutueshme, mund të ndiejnë keqardhje, pakënaqësi ose turp.
<b>Ata në dijeni</b>	Këta individë ose punojnë, ose aspirojnë të punojnë në profesion akademik ose shkencor. Ata e dinë se botimeve ose ngjarjeve u mungojnë besueshmëria, por duket se nuk u bëhet vonë. Shpesh duken të motivuar nga detyrimi për të pasur numër të madh prezantimesh ose botimesh në CV-të e tyre, që të mund të punësohen ose të promovohen. Kontribuesit në dijeni mund të pajtohen edhe që emrat t'u shtohen në komisionet organizuese ose bordet editoriale, që të mbushin më tej CV-të e tyre.
<b>Pseudoshkencëtarët</b>	Nëse këta kontribues e dinë se konferenca ose revista është e diskutueshme, pak rëndësi ka, sepse ata vetë mund të kenë kredenciale të dyshimta ose nocione të gabuara se çka përbën studim ose hulumtim. Këta individë ka gjasë se nuk kanë ndonjë post të besueshëm akademik a kërkimor, ndonëse mund të pretendojnë se janë shkencëtarë. Këta kontribues i përdorin konferencat dhe revistat e diskutueshme për të legjitimuar pohimet ose teoritë e tyre (zakonisht të paprovuara). Disa (megjithëse jo të gjithë) që përfshihen në “kërkime për avokim” (Beall, 2016) mund të bien në këtë kategori. Beall (2016) ndan disa shembuj të llojeve të kontributeve nga kjo kategori: pretendimet se asbesti nuk është toksik; pretendimet për mrekulli shërimi; mohimi i ndryshimeve të klimës; ose pretendimet për përgjigje në pyetje të papërgjigjura në kozmologji.



# Të kuptuarit e Qasjes së Hapur dhe të TPA-ve

Në fund të viteve 1990, natyra e botimeve shkencore dhe akademike filloi të ndryshojë me futjen e tarifave të përpunimit të artikujve (TPA), një model botimi në të cilin autorët paguajnë që artikujt t'u publikohen në format me qasje të hapur dhe online, (Abbott, 2017; Vinny et al., 2016). Ishte dikur një kohë kur akademikët mund ta kishin hedhur poshtë idenë që të pagunin për botimin e një artikulli të tyre në një revistë, por kohët kanë ndryshuar.

Ndonëse prezantimi i TPA-ve mund të ketë filluar me lëvizjen Qasja e Hapur (QH), Suber (p.d. 2012) jep një shtjellim të thukët të QH që shpjegon rrjedhshëm të gjitha tiparet kryesore, përfshirë kategoritë e ndryshme të QH si “të gjelbra” dhe “të arta”. Një shtjellim i thukët i të gjitha implikimeve të QH është përtej qëllimit të këtij raporti, prandaj ju rekomandoj të njiheni me punën e Suber-it për t'i kuptuar detajet.

Me ta thënë këtë, ja disa nga pikat kryesore të elementeve kyçe që karakterizojnë QH-në (Abbott, 2017; Suber, na, 2012):

- 1 Bazohet në parimin se hulumtimi i financuar publikisht duhet të jetë i disponueshëm falas për publikun (që ka paguar tashmë për hulumtimin me paratë e tatimeve).
- 2 E drejta e autorit mbetet te autori.
- 3 Punimi është i disponueshëm falas në format digjital për lexuesit, pa recetë ose ndalim për pagesë.
- 4 Është në përputhje me recensimin rigoroz. Me fjalë të tjera, thjesht pse një punim është në Qasjen e Hapur nuk do të thotë se nuk ka recensim rigoroz, ose se nuk duhet t'i nënshtrohet atij.
- 5 Mund të ndahet në një shumëllojshmëri formatesh si revista ose depo digjitale.
- 6 QH është një lloj i *qasjes*, jo një lloj modeli biznesi.

Gjatë njëzet vjetëve të fundit, shumëçka ka ndryshuar dhe tani TPA-të janë më të përhapura, madje edhe për revistat më të besueshme. Modeli i botimit që ekziston aktualisht nuk është i përsosur (Anderson, 2012), por është ai me të cilin duhet të merremi. E rëndësishme të theksohet është se nëse një revistë cakton tarifë të përpunimit të artikullit, kjo nuk është doemos tregues i kredibilitetit ose i cilësisë së saj. Është me rëndësi për autorët e ardhshëm t'i hetojnë detajet e një reviste dhe tarifave që ajo cakton para paraqitjes së dorëshkrimit.

# Revistat e dyshimta

Është shkruar shumë për temën e botimeve të dyshimta, si në burime studimore ashtu edhe në ato të përgjithshme. Me sa duket autori më i frytshëm dhe më autoritativ për këtë temë deri tash ka qenë Jeffrey Beall (nd, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 a, b, c). Që kur Beall e nisi fushatën e vetëdijësimit për t'i edukuar akademikët se çka janë revistat e dyshimta dhe si t'i shmangin ato, autorët e tjerë iu bashkuan në dialogun që u kthye në diskutim të shqetësimeve në qarqet akademike, shkencore e teknike.

## TIPARET E REVISTËS SË DYSHIMTË

Ja disa tipare që janë të zakonshme në shumë revista të dyshimta (Beall, 2016; Eriksson & Helgesson, 2017; Nolfi, 2015; Vinny et al., 2016):

- 1 Nuk burojnë ose nuk drejtohen nga një asociacion ose shoqatë e besueshme studiuere, akademike ose teknike, megjithëse disa pretendojnë se po.
- 2 Nuk marrin fonde ose grante publike (p.sh. qeveritare).
- 3 Dërgojnë e-maile spam.
- 4 Mburren për cilësinë e lartë të revistës, që mund të përfshijë pretendime të rreme për metrikat e revistës dhe vendin ku indeksohet.
- 5 Paraqet një kryeredaktor që redakton edhe shumë revista të tjera, nga një larmi disiplinash të ndryshme.
- 6 Bën pretendime të rreme në lidhje me vendndodhjen e revistës (p.sh. PUBMED).
- 7 Premton botim të shpejtë.
- 8 Premton shqyrtim dhe proces të lehtë nga kolegët.
- 9 Ka titull shumë të ngjashëm me atë të revistave legjitime shumë të respektuara, me vetëm pak modifikime delikate.
- 10 Mund të përfshijë fjalët, “International”, “World”, “Global” ose “Universal” në titull.

- 11** Pretendon të jetë i vendosur në qytete të mëdha (p.sh. Londër ose Nju Jork), kur në të vërtetë botohet diku tjetër.
- 12** Jua bën të vështirë të zbuloni se kush e menaxhon revistën.

Këto janë shenja që një autor i ardhshëm mund t'i kërkojë përpara se ta paraqesë punimin e vet në një revistë për botim. Është me rëndësi të mbani në mend se asnjëra prej këtyre karakteristikave në vetvete nuk është garanci që një revistë është e dyshimtë (Nolfi et al, 2015). Për shembull, janë disa revista shumë të besueshme me fjalët “International” në titull siç është *International Journal of Computer Vision*, që në kohën e këtij shkrimi figuron në vendin 105 nga më se 28.000 revista<sup>2</sup>. Ekzistojnë edhe revista që janë “amatore por synimmira” (Abbott, 2017, f. 6), që mund të kenë disa nga këto karakteristika, por synojnë ta ndërtojnë kredibilitetin e tyre me kalimin e kohës.

Si autor që kërkon një revistë me cilësi të lartë për ta publikuar hulumtimin, kërkonte një kombinim të këtyre karakteristikave dhe jini të vëmendshëm ndaj revistave që shfaqin tipare të shumta të revistave të dyshimta.

## SI TA KUPTONI KU TA PUBLIKONI PUNIMIN TUAJ?

Autorët e ardhshëm mund të ndihen të hutuar për atë se ku duhet t'i dorëzojnë për shqyrtim dorëshkrimet (Christopher & Young, 2015). Konsultimi i uebfaqes së Beall-it<sup>3</sup> është me siguri vend i shkëlqyeshëm për të filluar. Drejtorja e Revistave me Qasje të Hapur<sup>4</sup> po ashtu ofron njohuri se cilat revistat janë me qasje të hapur dhe të ligjshme. Vlen të përmendet se asnjëra prej këtyre faqeve në internet nuk është shteruese dhe autori i vëmendshëm do ta shikojë mirëfilli një revistë para se të paraqesë dorëshkrimin (Eriksson & Helgesson, 2017). Abbott (2017) këshillon autorët të kërkojnë revista me reputacion, si dhe qëllim e fushëveprim të mirëpërcaktuar, që synon “pikërisht llojin e lexuesit që autori e mendon si publik të artikullit të vet” (f. 6).

Një qasje joformale, por efektive për të përcaktuar se cilat revista t'i synoni, është të shikoni CV-në e ndonjë studiuesi ose hulumtuesi shumë të respektuar në fushën tuaj. Shpesh universitetet i publikojnë CV-të e profesorëve të tyre në internet, duke i bërë ato të qasshme për publikun. Një analizë joformale se ku botojnë studiuesit e lartë në fushën tuaj mund t'ju ndihmojë të krijoni një listë të revistave që doni t'i synoni për punën tuaj. Ngjashëm, nëse kërkonte këshilla nga ndonjë

2 Shih: Scimago Journal and Country Rank - <http://www.scimagojr.com/journalrank.php>

3 Shih: <https://beallist.weebly.com/>

4 Shih: <https://doaj.org/>

këshilltar ose mentor i besueshëm që është i respektuar në disiplinën tuaj, ai mund t'ju ndihmojë të orientoheni drejt revistave më me reputacion.

Këshillimi me një bibliotekar mund të jetë ndër mënyrat më të lehta për të gjetur revista me reputacion në fushën tuaj (Nolfi et al, 2015). Bibliotekat mund të jenë nga burimet më të dobishme dhe më të nënvlerësuara për studiuesit dhe hulumtuesit që kërkojnë të mësojnë më shumë rreth procesit të botimit akademik.

Hetimi i faktorit të impaktit të revistës (FI), si ai i prodhuar nga Thomson Reuters<sup>5</sup> mund të jetë mënyrë tjetër për të përcaktuar besueshmërinë e saj. Nuk vlen gjë që faktori i impaktit është tregues i kontestuar i cilësisë së revistës (Abbott, 2017). Revistat e dyshimta thjesht gënjejnë për faktorët e impaktit, prandaj mund të jetë e vështirë të kuptoni impaktin e vërtetë që ka revista. Ia vlen të bëni disa hetime për të kuptuar se si palët e treta objektivë e vlerësojnë faktorin e impaktit të një reviste që ju intereson.

---

5 Shih: faqja në internet e Thomson Reuters-it: <http://ipsciencehelp.thomsonreuters.com/inCites2Live/indicatorsGroup/aboutHandbook/usingCitationIndicatorsWisely/jif.html>

# Konferencat e diskutueshme

## TIPARET E KONFERENCËS VANITOZE OSE TË DYSHIMTË

Janë disa shenja paralajmëruese kyçe që tregojnë se një konferencë mund të jetë e dyshimtë. Ja disa karakteristika tipike të konferencave të rreme, që t'i keni parasysh para se të regjistroheshi (AuthorAID, 2017; Bowman, 2014; Beal, 2015; Cowan, 2016; McCrostie, 2016, 2017):

- 1 Ngjarja organizohet nga një entitet fitimprurës, e jo një asociacion a shoqatë e besueshme studiuese ose shkencore.
- 2 Konferencat që ndërthurin një varg temash e fushash ose disiplinash në një konferencë të vetme. Kini kujdes veçmas prej konferencave të pretenduara që kombinojnë tema të shumta të pandërlidhura në një ngjarje të vetme.
- 3 Konferenca përdor një adresë email-i falas, si p.sh. adresë në g-mail.
- 4 Organizatorët spamojnë pjesëmarrësit potencialë për të paraqitur propozime dhe për t'u regjistruar. Shpesh, këto email-e spam përshkruajnë me gjuhë hiperbolike se sa prestigjioze është konferenca.
- 5 Informacioni se kush po e organizon konferencën është ose i paqartë ose nuk ekziston; ose organizatori nuk ka reputacion ose nuk është i njohur.
- 6 Premtohet se përgjigjia për pranim do të dërgohet brenda një kohë shumë të shkurtër (shpesh më pak se katër javë).
- 7 Konferenca tregtohet si festë në një vend të dëshirueshëm. Ngjarja mbahet në një vend pushimi ose destinacion të njohur turistik dhe reklamohet më shumë si festë, sesa si ngjarje akademike a shkencore.
- 8 Emri i konferencës ka ngjashmëri të habitshme me atë të një konference të besueshme ose tejet prestigjioze, por ka dallime të vogla delikate në emrin e saj.
- 9 Organizatorët garantojnë se kontributi juaj do të botohet si artikull në revistën e lidhur me konferencën. Ashtu si konferenca, edhe revista është e dyshimtë dhe organizatorët më vonë mund të insistojnë në tarifa shtesë për përpunimin e artikullit para botimit të tij.
- 10 Uebfaqet e konferencës janë të paqëndrueshme. Ato mund t'i ndryshojnë URL-të ose të mos kenë historik të konferencave nga vitet e kaluara.

- 11 Teksti në internet përmban gramatikë të dobët ose gabime të shumta drejtshkrimore.
- 12 Tarifat e konferencës duken mjaft të larta krahasuar me ato që drejtohen nga asociacione ose shoqata studimore jofitimprurëse.

Secila prej këtyre karakteristikave në vetvete mund të mos tregojë një konferencë të dyshimtë. Për shembull, ndonjëherë konferenca të besueshme mbahen në destinacione të njohura turistike për të inkurajuar pjesëmarrjen. Shikoni për kombinimet e disave nga këto karakteristika dhe përdorni aftësitë e të menduarit kritik për të vlerësuar legjitimitetin e përgjithshëm të një konference.



Ndonjëherë pjesëmarrësit që janë joshur në konferenca të tilla, raportojnë më vonë mbi përvojat, që zakonisht përfshijnë (Beall, 2015; Cowan, 2016; Grove 2017 a, b; McCrostie, 2016; Ruben, 2016):

- 1 Pas mbërritjes në vendin e konferencës, pjesëmarrësit kanë raportuar se konferenca është anuluar në mënyrë misterioze.
- 2 Kishte njëfarë ngjarje, por nuk i ngjante një konference studimore ose shkencore në kuptimin tradicional. Mund të jetë ngjarje e zhvilluar në sallë të vetme takimesh në hotel, në vend se të përhapet në salla të shumta takimesh, siç do të bënte një konferencë e madhe akademike.
- 3 Mund të kenë marrë pjesë shumë pak njerëz (nganjëherë më pak se njëzet gjithsej).
- 4 Bashkëshortët dhe fëmijët e prezantuesve mund të kenë marrë pjesë në seanca për t'i mbushur sallat e konferencave.
- 5 “Konferencat” për disa tema ose disiplina të ndryshme (ndonjëherë të ndara si konferenca krejtësisht të ndryshme) mbaheshin në të njëjtën sallë, dhe prezantuesit ishin të vetmit në sallë. Të pranishmit e tjerë nuk kishin aspak interes për prezantimet e të tjerëve, sepse ishin joshur për të prezantuar një temë krejt tjetër.
- 6 Të pranishmit promovoheshin në folës kryesorë ose në kryesues të seancave. Më pas, emrat dhe fotot e tyre janë përdorur pa leje nga organizatorët e ngjarjeve për një varg të ngjarjeve të tyre.
